

Në bazë të nenit 24-a paragrafit 17 të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministrja e arsimit dhe shkencës përcaktoi

## **RREGULLORE**

### **për plotësimin e Rregullores për mënyrën dhe kriteret e përafërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve në lëndë të veçanta në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm**

#### **Neni 1**

Në Rregulloren për mënyrën dhe kriteret e përafërta të organizimit dhe realizimit të garave të nxënësve në lëndë individuale në nivel komunal, rajonal dhe shtetëror në arsimin e mesëm me nr. 13-15652/1 të datës 15.12.2025, në nenin 8 pas paragrafit 7 shtohet paragraf i ri 8, i cili thotë:

"Në përjashtim nga neni 6 paragrafi 2 i kësaj Rregullore, Ministria, më së voni në afat prej 5 ditëve të punës nga dita e sjelljes së Aktvendimit për marrjen e akreditimit të shoqatës së mësimdhënësve, në ueb-faqen e saj të internetit shpallë thirrje publike për akreditimin e shoqatës tjetër të mësimdhënësve e cila do të organizojë gara në lëndën/lëndët individuale si shoqata së cilës i është marrë akreditimi."

#### **Neni 2**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së sjelljes së tij.

Nr.13-4446/1

Shkup

Ministre e Arsimit dhe Shkencës  
Проф. д-р Весна Јаневска